




VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROŠEVAC

Më  
Dana

01-10-2018

P.nr.2100/17

  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtësen-praktikantja Albulena Topalli, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1098-7/2017 të dt.22.08.2017, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. I të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1098-7/2017 të dt.22.08.2017, për dhënen e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.20.10.2017 mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1098-7/2017 të dt.22.08.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

#### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Shtime, ku edhe jeton, i lindur me [REDACTED] nga babai [REDACTED] eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i martuar, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes se mësimë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I pandehuri [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Shtime ku edhe jeton, i lindur me [REDACTED] nga babai [REDACTED] eëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

#### ËSHTË FAJTORË

Se me datë 04.06.2017, rrëth orës 12:50, në fshatin Caraleve komuna e Shtimes i pandehuri [REDACTED] duke drejtuar automjetin e markës "Peugeot 306" me ngjyrë të kaltër me tabe atë regjistrimit [REDACTED] ka rrezikuar trafikun publik duke vë në rrezik jetën e njerëzve dë

pasurin e tyre me çrast ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 54.1 të LSKRR-se ashtu qe nuk ka përshtatur shpejtisë e lëvizëse automjetit te tije dhe nga pakujdesia derisa ka qene duke lëvizur rrugës tatëpjete me pjesën e përparme e godet ne këndin e majte te përparme automjetin e markës "vw Golf" me ngjyrë te zeze me tabela te regjistrimit [REDACTED] te cile e drejtonte i pandehuri [REDACTED] i cili ne momentin kritik nga pakujdesi nuk ka mbajtura distancën e nevojshme anësorë nga ana e majte me q rast i si pasoje e këtij aksidenti përvëç demit materiale të shkaktuare ne dy automjetet lëndime trupore pësoni i pandehuri [REDACTED]  
[REDACTED] si dhe e dëmtuara [REDACTED] e qe bazuare ne mendimin dhe konstatimin mjekologjore te datës 03.07.2017 lëndim te tillë bëjnë pjese në dëmtime te lehta trupore me pasoja te përkohshme për shëndetin

-me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut nga neni 378 par. 1 të KPK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

#### GJ Y K O N

Të pandehurin [REDACTED] me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Te pandehurin [REDACTED] me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjtë do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

E dëmtuara [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime për realizimin e kërkuesës pasurore juridike udhezohet ne kontest civil.

Obligohen të pandehurit që në emër të shpenzimeve te procedures te paguajnë shumen prej 60.88 ( gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tete cent) dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë secili veç e veç shumen prej 20 (njezete) € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën , PP/II.nr.1098-7/2017 të dt.22.08.2017 ka akuzuar të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED], për vepër penale rrezikim i trafikut nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1098-7/2017 të dt.22.08.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjkata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Që në fazën e administrimit të provave të merret rapporti i aksidentit me numër 2017-Cft-311 foto dokumentacioni i datës 01.07.2017 si dhe ekspertiza mjeko ligjore mbi natyrën e lëndimeve per te dëmtuarit e lartshënuarit e datës 03.07.2017 vërteton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara, dhe njëkohësisht vërtetojnë se të pandehurit e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, andaj gjykata të njëjtin i shpalli fajtor dhe iu shqipton dënimin me gjotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nen.458,459 dhe 460 të KPPK-së, e dëmtuara [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Shtime për realizimin e kerkesës pasurore juridike udhezohet ne kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumen prej nga 20€ në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

P.nr.2100/17 datë 20.10.2017

Procesmbajtësja

Albulena Topalli

Gjyqtarja Individuale

Hakile Ilazi



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.